

VENDIM
Nr. 15, datë 29.2.2012

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË SHNDËRRIMIT TË DEGËS SË BANKËS KOMBËTARE
TË GREQISË, TIRANË NË FILIAL/BANKË VENDASE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “e” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 29/1, nenit 29/2 dhe nenit 29/3 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e shndërrimit të degës së Bankës Kombëtare të Greqisë Tiranë, në filial/bankë vendase, kapitali i së cilës të zotërohet në masën 100% nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A. Greqi.
2. Miratimin e emrit të bankës “Banka NBG Albania” sh.a.
3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për nënshkrimin e formatit të ri të licencës dhe aneksit të licencës për “Banka NBG Albania” sh.a., pas regjistrimit të bankës në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, si dhe për verifikimin e plotësimit të kushteve të mëtejshme ligjore dhe/ose nënligjore nga banka.
5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani